



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

## **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 12.07.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar””.
2. Shqyrtimi nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”.
3. Raporti vjetor i veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017.

### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Nasip Naço, Edmond Panariti, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

**Mungojnë:** Enkelejd Alibeaj, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Fatmir Mediu, Silva Caka

### **Të ftuar:**

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë  
Klotilda Neziri – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë  
Mamica Dhamo – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë  
Adriana Jaku – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

Merita Xhafa – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes  
Sociale

Etleva Sheshi – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Adrian Shega – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë

Besa Shahini – Zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola – Drejtor Juridik në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Shkëlqim Ganaj – Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së

Evgjeni Bashari – Inspektore e Lartë në ILDKPKI

Flori Karaj – Inspektor i Lartë në ILDKPKI

Renata Teta – Specialiste në ILDKPKI

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi plotësohet për të diskutuar tri çështjet që kemi në rendin e ditës së sotme.

Çështja e parë është shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar”. Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi. Relatore është kolegja Elena Xhina.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zëvendësministri, zoti Elton Haxhi, zonja Klotilda Neziri dhe zonja Mamica Dhamo.

Zoti Zëvendësministër, mirë se keni ardhur në komision!

Pa humbur kohë, bëni një prezantim shumë të shkurtër për kolegët e komisionit, por edhe për opinionin publik. Ky projektligj do të shqyrtohet sot vetëm në parim, ndërsa shqyrtimin dhe miratimi nën për nën do të bëhet në seancat e radhës.

Edhe një herë, mirë se keni ardhur në komision!

Fjala është për ju.

**Elton Haxhi** – Faleminderit, kryetar!

Përpara keni projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”. Objektivi i përgjithshëm i projektligjit është fuqizimi i konsumatorëve nëpërmjet informimit të tyre për shitjet dhe shërbimet që ofrohen në treg, si dhe një mbrojtje më e madhe për ta, duke siguruar që mosmarrëveshjet ndërmjet tyre dhe tregtarëve të trajtohen nga struktura alternative jashtëgjyqësore, pa ua kufizuar të drejtën konsumatorëve për t’iu drejtuar gjykatës.

Ndryshimet kryesore që janë paraqitur në këtë, kanë të bëjnë me harmonizimin me legjislacionin europian të fushës së mbrojtjes së konsumatorëve, më konkretisht direktiva nr. 83/2011 dhe direktiva 11/2013.

Ndryshimi i dytë që synohet të arrihet ka lidhje me përcaktimin e rregullave për informimin e konsumatorëve për shitjen dhe shërbimet që ofrohen në treg.

Ndryshimi i tretë ka të bëjë me zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve nga struktura jashtëgjyqësore. Këto struktura janë pjesë e rregullatorëve në shërbimet publike. Për shërbimet që nuk bëjnë pjesë në shërbimet e rregulluara

publike këtë strukturë jashtëgjyqësore do ta marrë përsipër Ministria përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë.

Ndryshimi i katërt ka parashikuar disa dispozita në lidhje me delegimin e një pjesë të funksioneve të pushteti vendor në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve, të lidhura kryesisht me informimin, ndërgjegjësimin dhe mbledhjen dhe seleksionimin e ankesave të tyre. Këto janë ndryshimet që synon projektligji.

Nëse ka pyetje apo komente të tjera, ne jemi këtu për t'iu përgjigjur.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Haxhi!

Fjalën e ka relatorja, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” sjell disa shtesa dhe ndryshime të rëndësishme, të cilat, të them të drejtën, kanë një shtrirje të gjerë në këtë ligj.

Objektivi i përgjithshëm i projektligjit është fuqizimi i konsumatorëve nëpërmjet informimit të tyre për shitjet dhe shërbimet që ofrohen në treg, si dhe një mbrojtje më e madhe për ta, duke siguruar që mosmarrëveshjet ndërmjet tyre të zgjidhen në një mënyrë alternative, pa u kufizuar të drejtën konsumatorëve për t'iu drejtuar gjykatës, duke zbatuar dispozitat e Kodit Civil.

Projektligji konsolidon dhe thjeshtëson listën e detyrimeve për informacion, që duhet të japin tregtarët ndaj konsumatorëve në treg; konsolidon dhe qartëson kërkesat formale për kontratat jashtë qendrave të tregtimit dhe ato në largësi; rregullon me hollësi të drejtën për të hequr dorë nga kontratat e sipërcituara dhe mënyrën e ushtrimit të saj dhe pasojat e ushtrimit të kësaj të drejte, si dhe qartëson nocionet e dorëzimit të mallit dhe momentin e kalimit të rrezikut të mallrave etj.

Gjithashtu, ky projektligj sjell risi në fushën e marrëdhënieve midis tregtarëve dhe konsumatorëve, pasi paraqet ndryshime të ndryshme që lidhen edhe me shtesa në listën e përkufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi. Parashikohen përjashtimet nga fusha e zbatimit, ku përcaktohet se kontratat e shërbimit social, atij shëndetësor, lojërat e fatit, shërbimet financiare, tjetërsimi i sendeve të paluajtshme, ndërtimi i ndërtesave të reja, paketat e udhëtimit të përjashtohen nga zbatimi i pjesës VI, të ligjit nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

Parashikohen dispozita lidhur me informacionin parakontraktor për konsumatorin në kontrata të ndryshme të lidhura në largësi dhe detyrimin për informacion në kontrata të ndryshme

nga ato të lidhura në largësi apo jashtë qendrave të tregtimit. Pra, në përgjithësi projektligji sjell ndryshime të rëndësishme që rregullojnë në një fushë të gjerë marrëdhënien midis tregtarit dhe konsumatorit, por, gjithashtu, nga ana tjetër janë edhe disa çështje të tjera që duhen shtruar për diskutim nga komisioni ynë që është për dhënie mendimi për t'ia përcjellë më pas komisionit përgjegjës.

Janë tri çështje që kanë nevojë për qartësim, ndoshta edhe shpjegim nga ana e propozuesve të ligjit: në projektligj përkufizohen dhe detajohen kushtet e disa prej kontratave. Disa prej tyre janë përcaktuar dhe përkufizuar si kontrata tipike në Kodin Civil. Si qëndrojnë këto kontrata në raport me Kodin Civil, përkufizimet e parashikuara? A ka mundësi që këto parashikime ligjore të reja të kenë përplasje me dispozitat e Kodit Civil? A mund të sjellin këto dispozita të reja ligjore mundësinë që të kemi nevojë për ndryshime në Kodin në Civil?

Gjithashtu, vëmë re se ky projektligj u delegon disa funksione njësisive të qeverisjes vendore. A keni bërë ndonjë studim apo ndonjë konsulencë me njësitë e qeverisjes vendore, pra nëse ato janë të gatshme të marrin këto kompetenca të reja? A do të jenë efektive këto struktura të reja që kemi parashikuar të ngrihen, sepse në projektligj parashikohet të ngrihen disa organe, të cilat do të japin zgjidhje alternative për mosmarrëveshjet, meqenëse në projektligj është bërë një dallim nga procedura klasike e ndërmjetësimit, që, në fakt, parashikohet në ligjin e posaçëm? Këtu dua të shtoj faktin se me ndryshimet e reja ligjore në ligjin për ndërmjetësimin kemi shtuar një dispozitë, e cila u jep zgjidhje edhe problematikave ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit. Kjo u bë në bazë të direktivave të Bashkimit Europina dhe, në një farë mënyre, është pasqyruar kjo zgjidhje e problematikave. Mos duket sikur ngremë dy struktura paralele për të zgjidhur problematikat ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit në rrugë jashtëgjyqësore. Mendoj se këto pika kanë nevojë për diskutim dhe rishikim. Kur të bëjmë diskutimin nen për nen, do të kemi mundësi të diskutojmë. Në këto kushte, ju propozoj kolegëve të mi ta miratojnë në parim projektligjin, më pas do të kemi mundësi ta shohim nen për nen.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Xhina!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** – Zoti Zëvendësministër, keni sjellë të ndryshuar gjysmën e ligjit, apo jo?! Keni bërë mirë, por nga pikëpamja e teknikës legjislativë ligji ka vështirësi në përdorim. Pse nuk

keni sjellë një ligj të ndryshuar në mënyrë integrale, nga neni 1 deri te neni 50 e ca? Ju keni ndryshuar 30 nene. Nuk e di si e vlerësoni. Kjo nuk ka të bëjë me përmbajtjen, por me përdorimin dobiprurës të ligjit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Braho!

Po, ministria.

**Klotilda Neziri** – Ne e kemi diskutuar në atë kohë me Ministrinë e Drejtësisë nëse do të vinim më një projektligj të ri apo do të vinim me disa ndryshime. Duke parë se ishte vepruar në vendet e Europës, e lamë të bënim disa ndryshime, sepse ndryshimet dhe transpozimet kanë qenë vetëm dy direktiva shumë të rëndësishme, të cilat, siç thoni ju, janë dy direktivat më të rëndësishme për ligjin e mbrojtjes së konsumatorit jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vendet e rajonit dhe të Europës. Morëm vendimin të vinim vetëm me disa ndryshime.

**Ulsi Manja** – Pra, ky projektligj ka kaluar në qeveri me mendimin e Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

**Klotilda Neziri** – Absolutisht po.

**Ulsi Manja** – Ata nuk ju kanë sugjeruar që duhet një ligj i ri, por të zgjidhet forma e ndryshimit.

Fjalën e ka zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Në vazhdim të pyetjes së kolegut dhe të asaj që thatë ju se shumë shpejt ky ligj do të ketë ndonjë ndryshim tjetër, nëse ju kuptova qartë...

**Klotilda Neziri** – Këto janë direktivat më të rëndësishme dhe ndryshimi më i rëndësishëm që i bëhet ligjit, edhe sipas rregulloreve europiane.

**Vasilika Hysi** – Me logjikën tuaj do të ishte më mirë që të ishte ligji integral. Unë thashë se mos kjo ishte e përkohshme, sepse prisnim të reflektonim edhe direktivën e fundit plotësisht dhe kjo bënte sens për ta pasur një ligj më vonë. Rregulloret e Bashkimit European ndryshojnë me vite dhe automatikisht ne jemi të detyruar të bëjmë ndryshimet tona për të qenë në përputhje me transpozimin e direktivave. Sigurisht, ligji nuk përmban vetëm dy transpozime direktivash. Tregu ndryshon, sepse sot ne kemi ardhur këtu edhe nga nevoja e tregut. Tregu nuk është më të shkosh te dyqani e të blesh produktin apo të marrësh shërbimin. Tani bëhet edhe jashtë pikave të tregtimit, jashtë qendrave të tyre, edhe online. Pra, ka ardhur edhe si nevojë e tregut.

**Ulsi Manja** – Faleminderit! A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

E votojmë në parim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar””. Kush është pro në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar””. Siç e thashë edhe në fillim, shqyrtimi dhe miratimi nen për nen i këtij projektligji do të bëhet në mbledhjet e radhës.

Zoti Zëvendësministër, edhe një herë faleminderit për praninë tuaj në komision! Ju uroj ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.07.2018, ora 10:10

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Nasip Naço, Edmond Panariti, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

**Mungojnë:** Enkelejd Alibeaj, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Fatmir Mediu, Silva Caka

#### **Të ftuar:**

Adriana Jaku – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Merita Xhafa – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Etleva Sheshi – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Adrian Shega – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

Besa Shahini – Zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola – Drejtor Juridik në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë



**Ulsi Manja** – Kalojmë në shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”.

Komisioni i Ligjeve është komision përgjegjës në shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji. Relatore është kolegja Vasilika Hysi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zonja Adriana Jaku, zëvendësministre, zonja Merita Xhafa, drejtore e Përgjithshme dhe zonja Etleva Sheshi, përgjegjëse Sektori; nga Ministria e Drejtësisë zoti Adrian Shega, Drejtor i Përgjithshëm; nga Ministria e Brendshme zonja Rovena Voda, zëvendësministre dhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë zonja Besa Shahini, zëvendësministre dhe zoti Erzen Tola, drejtor Juridik. U lutem përfaqësuesve të katërt ministrive të zënë vendet në tryezën e komisionit. Këtë projektligj e kemi kaluar në parim. Sot do të bëjmë shqyrtimin dhe miratimin nen për nen e në tërësi të tij. Ndaj, do të ftoj kolegen Hysi, relatore e këtij projektligji, që së bashku me përfaqësuesit e ministrisë të ndjekin rendin e kalimit të neneve dhe aty ku ka ndërhyrje apo komente të marrin fjalën. Ndërkohë, për nenet e dakordësuara përfaqësuesit e ministrive të shprehen dakord me ndryshimet.

Zonja Hysi, fillojmë me nenin 1.

**Vasilika Hysi** – Para se të fillojmë me nenin 1, dua të them diçka për procesin. Kanë dhënë mendim Komisioni i Sigurisë Kombëtare dhe Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Njëkohësisht, bazuar në kërkesën që u keni drejtuar, të gjithë aktorët e shoqërisë civile dhe institucionet kanë sjellë mendime, si ekspertë të fushës, organizata të shoqërisë civile. Vetë Ministria e Brendshme ka bërë disa sugjerime për përmirësimin e draftit, pasi ka parë rekomandimet apo sugjerimet e sjella nga shoqëria civile, por edhe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në tabelën përpara, të nderuar kolegë, keni në një kolonë përmbajtjen e projektligjit sipas variantit të depozituar në Kuvend; në kolonën e dytë keni propozimet e komisioneve për dhënie mendimi; në kolonën e tretë janë amendamentet, përmirësimet që ne kemi bërë, unë në cilësinë e relatores së bashku me kolegun Bushka, që ka një përvojë në këtë rast, me këshilltaren ligjore të komisionit, zonjë Isida Koka, por edhe me përfaqësuesit e ministrive të linjës, duke dhënë përgjigjet pse një propozim merret në konsideratë dhe një tjetër nuk merret.

Në lidhje me nenin 1, zoti kryetar, kemi bërë një riformulim. Për shkak të numrit të madh të ndryshimeve që kemi bërë, do të kalohet në formë integrale. Ndryshimet janë të teknikës legjislative.

**Ulsi Manja** – Neni 1, me riformulimet e bëra nga relatorja dhe që janë dakordësuar me përfaqësuesit e qeverisë. Kush është pro nenit 1 sipas variantit integral? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

**Vasilika Hysi** – Para se të kalojmë te neni 2, dua t'ju bëj me dije se pika 3 dhe pika 4 e nenit 1 në variantin e qeverisë janë pranuar, por kalojnë te neni 3. Kështu që pas nenit 1 shtojmë një nen të ri, neni 1/1, i cili ka një rregullim të teknikës legjislative për ta përafuar këtë ligj edhe me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi; fjalët “fuqizim të gjyqësorit” i kemi bërë “fuqizim të sistemit gjyqësor”, pra është thjesht teknikë legjislative për të përafuar terminologjinë.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 2, sipas riformulimit të bërë nga relatorja në tekstin integral? U lutem zëvendësministrave të shprehen për dakordësinë me riformulimin!

*(Zëvendësministrat shprehen dakord.)*

Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3.

**Vasilika Hysi** – Neni 2 i ligjit ndryshon nenin 3 të ligjit në fuqi. Ka sugjerime nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Njëkohësisht, ka edhe një sërë përmirësimesh të bëra nga i gjithë grupi i përfaqësuesve të ministrisë, nga unë dhe nga këshilltarja. Ndryshimi i parë është i teknikës legjislative. Kemi përfshirë të gjitha përkufizimet, ku përkufizim i ri ne këtë nen është urdhri paraprak i mbrojtjes së menjëhershme, i cili është një institut i ri i parashikuar. Njëkohësisht, kemi parashikuar edhe një përkufizim të ri lidhur me mekanizmin e referimit që ngrihet në nivel vendor. E gjithë ideja është për të pasur një gjuhë sa më lakonike në ligj, prandaj e kemi shtuar këtë përkufizim.

E dyta, lidhur me variantin e sjellë nga qeveria, kemi bërë disa riformulime. Nocioni i dhunës në familje është riformuluar bazuar në propozimin e Shkollës së Magjistraturës duke zbatuar përkufizimin që jep Konventa e Stambollit.

E dyta, është përdorur fjala “dhunues” dhe jo gjithmonë fjala “autor i veprës penale”, sepse kur personi shkon e denoncon, personi është dhunues, pra nuk ka filluar ende procedimi penal. Gjithashtu, është përkufizuar njësia shtëpiake, që quhet banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes. Pra, kemi hequr atë rregull që thuhet të paktën të kenë jetuar tre muaj. Përkufizimi i ri është: “Mekanizimi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje, i organizuar si një rrjet i koordinuar institucionesh përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. Gjithashtu, me propozim të profesorëve të Shkollës së Magjistraturës, por edhe të Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të Prokurorisë së Përgjithshme kemi qartësuar se cilët do të quhen pjesëtarë të familjes. Përkufizimin e kemi te pika 7.

Ka pasur një debat lidhur me mundësinë e mbrojtjes se personave që nuk janë bashkëjetues, nuk janë partnerë të lidhur në kurorë, por janë thjesht të dashur. Debatimi është bërë dhe ne kemi hasur pak vështirësi. Këta persona duhen mbrojtur. Është rasti i vajzës në Tiranë që u vra në rrugën “Don Bosko”, ose studentes që u vra para dyerve të Fakultetit të Mjekësisë, që nuk janë as bashkëjetues, as partnerë, as ish-bashkëshortë, por kanë pasur një lidhje intime në çift. Propozimi i sjellë nga qeveria është “lidhje afektive”, por rrjeti i organizatave që janë për parandalimin e dhunës, por edhe Shkolla e Magjistraturës dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë ngritur shqetësimin që në praktikë koncepti “afektiv” krijon probleme, pra nuk arrin të kuptohet.

Ne kemi bërë një sugjerim: “Personat të cilët janë ose kanë qenë në lidhje intime në çift, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje.” Pra, me këtë kategori mbrojmë edhe kategorinë e personave, të cilët mund të kenë një afeksion...

**Ulsi Manja** – Pra, keni shqipëruar fjalën “afektive”.

**Vasilika Hysi** – E kemi shqipëruar, por edhe Konventa e Stambollit (përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mund ta citojë), i jep mbrojtje edhe kategorisë së personave të tillë, të cilët mund të përndiqen, sepse dikush i adhuron, por që realisht nuk janë çift, ose në bashkëjetesë.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, përfaqësuesve të ministrive dhe zëvendësministrat kur të marrin fjalën të prezantohen.

**Etleva Sheshi** – Përshëndetje!

Unë jam Etleva Sheshi, përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shefe e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në familje.

Në këtë përkufizim i kemi referuar nenit 3 të Konventës së Stambollit e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, e cila përkufizimin e dhunës në familje e paraqet si dhunë intime të partnerëve ose ish-partnerëve, përfshirë dhunën fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike. Duke iu referuar këtij neni është menduar që të lihet “në lidhje intime”.

**Ulsi Manja**- Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Unë personalisht jam dakord dhe, në qoftë se edhe anëtarët janë dakord, po prezantojmë edhe një ndryshim të ri.

Bazuar në kërkesën e rrjetit kundër dhunës në marrëdhëniet familjare ka gjetur rregullim edhe parandalimi i dhunës midis vëllezërve dhe motrave të bashkëshortit, bashkëshortes dhe bashkëjetuesve, që ne i quajmë kunetërit dhe kunatat. Ligji nuk e parashikonte këtë rregullim, por në shumë pjesë të territorit të Shqipërisë ose në disa familje, ku jeton një familje e madhe, dhuna mund të jetë midis kunatit ose kunatës. Në këtë kuadër, ky propozim është sjellë nga rrejtji kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, e cila është kërkesë e Konventës së Stambollit dhe kërkesë e pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës.

Gjithashtu, me ndryshimet që ne i bëjmë këtij neni, kemi parashikuar edhe parandalimin e rasteve të dhunës nga kujdestari për personat me aftësi të kufizuar. Kjo është një kërkesë e ardhur nga Fondacioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe nga Shkolla e Magjistraturës. Shpesh personat me aftësi të kufizuar mund të jenë viktimat të dhunës në familje dhe kanë nevojë për një mbrojtje të posaçme, për më tepër që Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një ligj të posaçëm lidhur me ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i cili rregullon edhe kujdestarinë. Ne kemi rënë dakord edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale, por njëkohësisht edhe me ekspertët, që kanë punuar për ligjin.

Gjithashtu, kemi bërë një riformulim të konceptit që mbrohen si pjesëtarë të familjes nga ky ligj, edhe prindërit e bashkëshortit ose bashkëjetuesit, përfshirë thjeshttrin dhe thjeshttrën, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi dhe jo detyrimisht të jetojnë në një familje, pasi gjithmonë i kemi konsideruar se patjetër duhet të ndajnë të njëjtën banesë.

Ka pasur një diskutim lidhur me një koncept tjetër për urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme. Urdhri paraprak i mbrojtjes së menjëhershme nuk është një institut i parashikuar në ligjin e vitit 2006 dhe i ndryshuar në vitin 2012. Ai parashikohet si një reagim i menjëhershëm

për të parandaluar dhe mbrojtur nga dhuna në familje me një urdhër të arsyetuar, që tashmë do ta lëshojë punonjësi i Policisë së Shtetit. Kjo ka qenë çështja më e diskutuar midis Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme, ekspertëve, por edhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Faktikisht të gjitha grupet e interesit, të gjithë ekspertët dhe vetë Prokuroria e Përgjithshme kanë ngritur një shqetësim, që për 48 orë i lënë viktimat pa mbrojtje. Pra, deri në momentin që gjykata shprehet për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, dhunuesi dhe viktimat qëndrojnë në një shtëpi, por ai mund të mbajë armë dhe nuk është i detyruar të largohet nga banesa. Pra, brenda 48 orëve, ajo që gjykata duhet të bëjë, krijon një vakum ligjor. Kemi ardhur me dy variante. Varianti i parë është nëse do të quhet urdhri paraprak i mbrojtjes i lëshuar nga punonjësi i policisë apo do t'i quajmë masa paraprake të mbrojtjes së menjëhershme. Pra, ne kemi sjellë dy përkufizime. Përkufizimi i parë është nga grupi i ekspertëve i dakordësuar me ministrinë përgjegjëse, atë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe varianti dytë i propozuar nga Ministria e Brendshme, pika 11 “Masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme janë masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit pas kryerjes së vlerësimit të riskut”.

Edhe para fillimit të kësaj mbledhjeje ne kemi pasur dilemat tona se sa mund të garantohet në praktikë një gjë e tillë.

**Ulsi Manja-** Zonja Hysi, jemi te neni 3, te përkufizimet. Çfarë problemi ka te ky nen?

**Vasilika Hysi** – Janë dy variante.

**Ulsi Manja-** Urdhri paraprak i mbrojtjes së menjëhershme dhe urdhër i menjëhershëm mbrojtje. A keni rënë dakord se cilët do të konsiderohen pjesëtarë të familjes?

**Vasilika Hysi** –Po, kemi rënë dakord.

**Ulsi Manja** – A keni rënë dakord për germën “e”, “Persona, të cilët janë ose kanë qenë në lidhje intime në çift, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetese, gëzojnë të njëjtën mbrojtje”? Jeni dakord me këtë riformulim, edhe pse e keni zgjeruar shumë konceptin se kush konsiderohen pjesëtarë të familjes?

**Etleva Sheshi** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Unë nuk e di se si ka qenë dakord Policia e Shtetit me këtë koncept, por kjo çështje do të duhet të vërtetohet rast pas rasti, sepse i bie që 10 mijë forcave policore t'i japin mbrojtje çdo njeriu që është në një lidhje intime apo afektive. Zonja Hysi thotë që kjo do të bëhet me vetdeklarim, por nuk e di.

Jam dakord që është shqetësim, dhe rasti i “Don Boskos” është problem, por duhet të bëjmë një ligj dhe të japim një koncept të zbatueshëm në praktikë. Si do të zbatohet në praktikë kjo, pasi do të krijojë vështirësi shumë të mëdha për Policinë e Shtetit, aq më tepër që me këtë ligj i jepet një ngarkesë e tillë?

Gjithsesi, zonja Voda fjala për ju.

**Rovena Voda** – Dua të bëj vetëm një koment.

Në fakt, duke dëgjuar me vëmendje atë që tha zonja Hysi, për këtë çështje ka pasur diskutime edhe në tryezat teknike që janë bërë dhe është e vërtetë që puna e Policisë së Shtetit është shumë voluminoze, por kjo ka ardhur si rezultat i një analize të rasteve që kanë ndodhur në praktikë dhe shpeshherë ndodh që gishti vihet te Policia e Shtetit. Pra, në qoftë se ndodh një fatkeqësi, e para që anatemohet është Policia e Shtetit “Pse Policia e Shtetit nuk mori këtë masë?” “Pse e la të lirë” “Pse nuk e mbajti?”. Sigurisht që do të jetë barrë dhe në praktikë do të ketë vështirësi, por, meqenëse qëllim i të gjitha këtyre ndryshimeve që ne po bëjmë është pikërisht ajo çfarë ka rezultuar nga rastet në praktikë, të mund t’i vëmë një barrierë, pra të mos kemi raste të tilla fatkeqësish. Kjo do të jetë një detyrë e shtuar për Policinë e Shtetit, por që do të mundohemi ta menaxhojmë, ashtu sikurse Policia e Shtetit ka bërë me të gjitha llojet e veprave penale.

I nderuar zoti kryetar i komisionit, meqë e mora fjalën, dua të bëj një koment të shkurtër për urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme apo masat paraprake. Unë i qëndroj variantit të parë, urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme dhe jo për masën paraprake. Këto ishin komentet e mia.

**Ulsi Manja**- Domethënë, ju, përfaqësuesit e ministrisë, jeni dakord për variantin 1.

Po, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni**- Së pari, duhet të jemi pak të kujdesshëm dhe t’i lëmë kohë relatores për ndonjë rast të veçantë që të koordinohet, sepse po të vazhdojmë me diskutime të pafundme nuk do t’ia dalim dot.

Së dyti, jam dakord se çdo term të ri që do të fusim duhet ta definojmë në nenin 2. Pra, duhet të ketë definicion të qartë. Vetëm kështu e ndihmojmë praktikën, sepse po të flasim rast pas rasti në praktikë, ne e çojmë në pamundësi zbatimin ose zbatim në formë të ndryshme. Për shembull, rastit në lidhje intime në çift duhet t’i japim definicion, sepse nuk mund ta lemë me kaq, sepse një polic në Kurbin thotë që lidhje intime është edhe po t’i shkelësh syrin dikujt, kurse një tjetër do të

kërkojë kryerjen e intimitetit. Kjo është shumë evazive dhe në praktikë mund të sjellë probleme. Kështu që, ose duhet ta definojmë, ose do të gjejmë një variant tjetër.

**Ulsi Manja** – Unë jam dakord me propozimin e zotit Hyseni, që këtë nen ta lëmë të hapur për të pasur një definim të qartë të formulimeve të këtij neni.

Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Unë jam shumë dakord, zoti kryetar, sepse kjo ka qenë një ndër pikat që ne kemi diskutuar disa ditë rresht, edhe sot para mbledhjes, por nuk ka një përcaktim. Ne iu referuam raportit shpjegues të Konventës së Stambollit, ku thuhet: “Shtetet kanë detyrimin të rregullojnë edhe rastet kur dikush përndiqet”. Kemi rastin e dy studenteve, që kishin shkuar në polici dhe kishin kërkuar urdhër mbrojtje, dhe me të drejtë policia i ka thënë që nuk janë subjekt i ligjit dhe kështu lënë një kategori njerëzish pa mbrojtje. Në këtë kuadër, propozimi që ka ardhur është “marrëdhënia afektive”, nuk gjetëm përkufizim të marrëdhënies afektive as në Kodin e Familjes, prandaj mendoj ta lëmë të hapur.

Unë mendoj që propozuesit e ligjit, bashkë me ekspertët që kanë punuar për përgatitjen e draftit të ligjit, të bëjnë një formulim, sepse nuk jam eksperte në të drejtën e familjes. Në anglisht gjendet fjala, por në shqip jo.

**Ulsi Manja** – Po, zonja Xhafaj.

**Merita Xhafa** – Unë jam Merita Xhafa, drejtore e Përgjithshme e Politikave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Lidhja afektive ndoshta nuk ka një përkufizim të saktë në terminologjinë afektive, por ajo përkthehet.

Për sa i takon lidhjes intime, në Kodin e Familjes është parashikuar se familja krijohet mbi bazën e lidhjeve të dashurisë apo një raporti reciprok ndërmjet dy partnerëve.

Nga pikëpamja e standardeve ndërkombëtare ka përkufizim për lidhjen afektive apo edhe për lidhjen intime, siç mund të përkthehet në shqip. Në qoftë se ne duam ta përfshijmë në përkufizimet e këtij projektligji, në nenin 2, ne jemi të gatshëm të përgatisim përkufizimin përkatës.

**Vasilika Hysi** – Të nderuar kolegë, unë jam dakord që ta lëmë të hapur germën “ë” te pika 7 e nenit 2, që ndryshon nenin 3. Meqenëse nuk kemi gjetur dakordësi është sjellë në komision edhe pika 11, që në projektligj është pika 10 e këtij neni, ku thuhet: “Urdhri paraprak i mbrojtjes ose masat paraprake”. Zëvendësministrja e Punëve të Brendshme ishte dakord me urdhrin paraprak të mbrojtjes. Në qoftë se kolegët janë dakord, mund të...

**Ulsi Manja-** Zonja Hysi, cilin nen do ta shtyjme për diskutim?

**Vasilika Hysi** – Jemi te neni 2 i projektligjit të sjellë nga qeveria, i cili ndryshon nenin 3 të ligjit në fuqi “Përkufizimet”.

**Ulsi Manja** –Ju lutem, mos më ngatërroni se cilat nene ndryshohen, por t’i rrimë variantit të projektligjit. Jemi te neni 2, që ndryshon nenin 3. Ju, si relatore, mund të thoni se cili nen ndryshohet, ndërsa unë do të hedh në votim nen për nen nenet që ka teksti i projektligjit. Pra, neni 2 shtyhet për t’u miratuar më vonë.

Kalojmë te neni 3.

**Vasilika Hysi** – Për nenin 3, te varianti i qeverisë shtohet një nen i ri, neni 3/1, për të cilin ka komente dhe sugjerime nga Komisioni i Sigurisë Kombëtare dhe nga kolegja Bushka.

Ne kemi bërë një riformulim të këtij neni, ku përveç paragrafit të parë të projektligjit, kemi shtuar edhe dy pika të tjera, pikat 2 dhe 3. Në pikën 2, thuhet: “Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në pikën 3, thuhet: “Masat e veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe nenin 13/1 të këtij ligji, që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kritereve të parashikuar në këtë ligj”. Në këtë pikë ne kemi reflektuar pjesërisht edhe sugjerimin e bërë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në fakt, këto pika nuk janë të shtuara, por në projektligjin e qeverisë kanë qenë si pikë 3 dhe 4, ndërsa ne i kemi sistemuar këtu.

**Ulsi Manja** – A janë dakord përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme, të Ministrisë së Arsimit dhe të Ministrisë së Shëndetësisë me nenin 3 dhe riformulimet përkatëse?

**Etleva Sheshi** – Po, dakord.

**Ulsi Manja-** Hedhim në votim nenin 3. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te nenin 4.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, para se të kalojmë te neni 4, për shkak të ndryshimeve që kanë bërë edhe komisionet për dhënie mendimi, sugjeroj që të ndryshojmë nenin 4 të ligjit aktual, i cili nuk ka ardhur si propozim i projektit nga Këshilli i Ministrave, por ka ardhur si rezultat i mendimeve të shprehura nga Komisioni i Sigurisë Kombëtare dhe grupet e interesit.

Këshilltarja, Isida, do ta lexojë përmbajtjen e këtij neni.



**Ulsi Manja** – Pra, bëhet fjalë për nenin 4, i cili ndryshon nenin 5?

**Vasilika Hysi** – Jo, është nen i ri.

**Isida Koka** - Propozohet një nen i ri, i cili ndryshon nenin 4 të ligjit aktual “Subjektet”. Ky nen do të trajtojë subjektet që mbrohen nga ky ligj, që janë shtetasit shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, që përfshihen në kategorinë e pjesëtareve të familjes, si dhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme sipas legjislacionit në fuqi për të huajt, që përfshihen në kategorinë e pjesëtareve të familjes.

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me këtë ndërhyrje te neni 4?

**Etleva Sheshi** – Dakord.

**Vasilika Hysi** –Ideja e këtij neni është që nuk kanë mbrojtje vetëm shtetasit shqiptarë, por edhe të huajt dhe azilkërkuesit, i cili është detyrim që rrjedh nga Konventa, por edhe nga ligji për azilin dhe të huajt, që janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

**Ulsi Manja** –Kush është dakord me këtë nen të shtuar, i cili ndryshon nenin 4?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4, që ndryshon nenin 5.

**Vasilika Hysi** –Neni 4 ka riformulime të teknikës legjislative.

**Ulsi Manja**- Zonja Hysi, për ekonomi kohe, në qoftë se i keni dakordësuar këto nene, nuk është e nevojshme që të lexohen riformulimet e bëra, sepse për 19 nene që kemi, mund të rrimë deri në 17:00 këtu. Dakord?

**Vasilika Hysi** – Dakord.

Neni 4 ka riformulime të teknikës legjislative.

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me ndryshimet e bëra në nenin 5?

**Etleva Sheshi** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 4 që ndryshon nenin 5, sipas riformulimeve të bëra nga relatorja? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 4.

Kalojmë te neni 5, që ndryshon nenin 6.

**Vasilika Hysi** – Ky nen, bazuar në sugjerimin e bërë nga Komisioni për Punët dhe Çështjet Sociale, ka një ndryshim në germën “c”, pika 1, ku sugjerohet që pas fjalës “së nevojshme” të shtohet togfjalëshi “në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”. Gjithashtu, bazuar në komentet e grupeve të interesit, kemi bërë një amendim për germën “ç” të pikës 1, të cilin e keni përpara. Këtu është marrë në konsideratë edhe sugjerimi i Komisionit të Sigurisë dhe UNICEF-it.

Gjithashtu, ka një sugjerim për riformulim të germës “d”, duke shtuar edhe detyrimin që do të ketë ministria përgjegjëse, autoriteti përgjegjës për të raportuar pranë komisionit përgjegjës në parlament ose nënkomisionit për çështjet e barazisë gjinore lidhur me mbledhjen e të dhënave statistikore, si dhe një ndryshim tjetër, që botimi, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave do të bëhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.

Gjithashtu, në pikën 3, germa “g”, ka një riformulim, shtohet një shprehje; “harton politikën dhe mbikëqyr” dhe bazuar në propozimin e UNICEF-it, në germën “gj” ka një riformulim, por njëkohësisht kemi shtuar një togfjalësh në germën “h”, ku shtohet shprehja “dhe monitorimin dhe zbatimin e tyre”. Ky është propozimi i Komisionit të Punës dhe organizatave të shoqërisë civile. Është shtuar edhe një germë tjetër “h/1” lidhur me detyrën që ka autoriteti përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe funksionimit të shërbimeve të përkujdesit shëndetësor për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Këto janë ndryshimet.

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me ndryshimet e bëra nga relatorja për nenin 5?

**Etleva Sheshi** - Dakord!

**Ulsi Manja**- Atëherë, hedhim në votim nenin 5. Kush është dakord me formulimet e bëra në tekstin integral të projektligjit dhe të dakordësuar me përfaqësuesit e ministrive? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 6, që ndryshon nenin 7.

**Vasilika Hysi** – Për këtë nen kanë dhënë sugjerime Komisioni për Sigurinë Kombëtare dhe Komisioni për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, por kemi pasur sugjerime edhe nga grupet e interesit. Formulimi për pikën 1 është fjali hyrëse dhe është thjesht teknikë legjislative, ku thuhet: ‘Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike’. Në germën “b” të pikës 1 kemi

bërë një riformulim të kësaj germe sipas draftit që ju e keni përpara, pra “lidhur me trajnimet e punonjësve të Policisë së Shtetit...

**Ulsi Manja** – Janë ndryshime të dakordësuara.

**Vasilika Hysi** – Po, janë të gjitha të dakordësuara

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me nenin 6, me ndryshimet e dakordësuara në tekstin integral?

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, te germa “b/2” është riformuluar germa “b/1”, gjithashtu kemi riformulim në pikën 3, të pikës 2/1 të germave “a”, “b” dhe “c”, sipas tabelës që keni përpara

**Ulsi Manja** – Dakord Ministria e Drejtësisë?

**Vasilika Hysi** – Jemi dakordësuar me të gjitha ministritë.

**Adrian Shega** – Për sa u përket detyrave të Ministrisë së Drejtësisë, te pika 3, germa “ç”, është bërë një parashikim në lidhje me Ministrinë e Drejtësisë për faktin se merr masa për të parashikuar edhe përfaqësuesin procedural të fëmijëve”. Në lidhje me këtë pikë, ne sugjerojmë që të hiqet, pasi nuk është pjesë e detyrave të Ministrisë së Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë, në bazë të ligjit “Për të miturit”, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, nxjerr një udhëzim në lidhje me kriteret që duhet të kenë përfaqësuesit, pra cili mund të jetë përfaqësues procedural. Ndërsa përfaqësuesi procedural nxirret nga organet përkatëse, të cilat janë gjykata, prokuroria dhe punonjësit e policisë nga lista e përpiluar nga bashkia.

**Ulsi Manja** – A është hequr kjo që sugjeron?

Relatorja.

**Vasilika Hysi** – Po, zoti kryetar, kemi pasur një diskutim shumë të gjatë midis ministrive. Iu referuam edhe ligjeve që ka miratuar Kuvendi, nuk na dilte e qartë arsyeja pse e kanë sugjeruar. Kështu që përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, por edhe të Shëndetësisë dhe të Punës Sociale thonë se germa “ç” duhet hequr.

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me sugjerimin e bërë nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë.

**Merita Xhafa** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 6?

**Vasilika Hysi** – Edhe për riformulimet në pikat 5 dhe 6, siç është dakordësuar.

**Ulsi Manja** – Kur flas për riformulime të tekstit integral dhe të dakordësuar me ministrinë, nuk është nevoja t'i lexojmë një për një. Më mjafton shprehja e vullnetit të përfaqësuesve të qeverisë që kam këtu.

Kush është dakord me nenin 6, me riformulimet e bëra dhe të dakordësuara me qeverinë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6, sipas variantit integral në tekstin e projektligjit.

Kalojmë te neni 7, sepse ka aq shumë riformulime, sa duhet të kalosh 10 faqe për të shkuar te neni.

Neni 7.

Urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Pas nenit 7, shtohet një nen i ri 7/1, është në variantin e qeverisë, por është riformuluar bazuar në mendimin e sjellë nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare, nga Komisioni për Punën dhe Çështje Sociale, të cilët kanë marrë në konsideratë opinionin që ka sjellë ADRF-ja, Rrjeti i Monitorimit të Dhunës në Familje, por, njëkohësisht, edhe propozimet që ka bërë UNICEF-i. E gjithë ideja është garancia për mbrojtjen e viktimave.

Zoti kryetar, për kujtesë, për ata që do të zbatojnë ligjin më pas: “Viktimat e dhunës në familje do të mbrohen pavarësisht vendbanimit ose vetëqëndrimit të tyre. Në rast se gjatë ekzekutimit të një urdhri mbrojtjeje lind nevoja të lëvizin nga një vendbanim tjetër në vendqëndrim, nga një vendqëndrim në një tjetër, masat e mbrojtjes së tyre duhen patjetër të garantohen”. Pra, nuk do të lidhet garantimi i mbrojtjes se ku ka gjendjen civile apo ku ka personi banesën. Kjo duhet bërë e qartë si për punonjësit e policisë, ashtu edhe për mekanizmat e referimit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Pra, neni 7 “Garancia për mbrojtjen”.

Ministria, a jeni dakord?

**Besa Shahini** – Dakord.

**Merita Xhafa** - Dakord.

**Ardian Shega** – Dakord.

**Ulsi Manja** –Kush është dakord me nenin 7, me riformulimet e bëra në tekstin integral? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8.

**Vasilika Hysi** – Për nenin 8 ka ardhur një ndryshim nga qeveria, që në pikën 3 të nenit 8 të ligjit ekzistues, pas germës “d” të shtohet një germë “dh”. Ky nen është diskutuar në Komisionin për Punën, e Çështjet Sociale dhe të Shëndetësisë, njëkohësisht për këtë nen, ka mendime me dhe sugjerime, edhe nga Rrjeti i Monitorimit të Dhunës në Familje dhe nga ADRF-ja, kemi bërë edhe një riformulim bazuar në propozimin e ekspertëve të UNICEF-it, që është i dhënë në ligj. Zoti kryetar, i vetmi shqetësim është, dhe këtë e kam pyetje për ministrinë, sepse është një shprehje, për të cilën ka kundërshti qoftë UNICEF-i, por edhe unë vetë nuk mendoj se është e drejtë. A mundet që punonjësit socialë për çështjet e dhunës në familje të përgatisin një raport të shëndetit mendor të viktimës të dhunës?

**Ulsi Manja** – Ministria e Shëndetësisë.

**Merita Xhafa** – Raporti për shëndetin mendor përgatitet nga psikologu në bashkëpunim me ekspertin, që është në fushën e shëndetit mendor. Kështu që punonjësi social, realisht, bën koordinimin dhe kjo do të jetë pjesë e planit që ne propozojmë, pra të mos quhet “plan personal i ndërhyrjes”, por “plan individual” duke ardhur në të njëjtën linjë me ligjin “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

**Vasilika Hysi** – Nëse ju kuptova drejt, zonja Xhafa, sepse në riformulimin që është sjellë këtu thuhet: “Punonjësi social për çështjet e dhunës në familje pranë njësisë së qeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit përgatisin raport të shëndetit mendor të gjendjes psikologjike të viktimës dhe rekomandon një plan individual ndërhyrjesh, masash dhe shërbimesh të nevojshme, që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe kufizimin e pasojave të dhunës ose minimizimin”. Me fjalë të tjera, punonjësi social do ta bëjë raportin?

**Merita Xhafa** – Po, “në bashkëpunim me anëtarët e mekanizmit të referimit”.

**Vasilika Hysi** – Ta shtojmë?

**Merita Xhafa** – Po.

**Ulsi Manja** – Po nuk e bëri punonjësi social, kush do ta bëjë në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Merita Xhafa** – Mekanizmi i referimit është në nivel të njësive të vetëqeverisjes vendore. Prandaj edhe punonjësi social, i cili merret direkt me mekanizmin...

**Ulsi Manja** – Pyetja që shtron kolegia Hysi, a mund ta bëjë punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore, apo duhet psikiatri? Nëse nuk do ta bëjë punonjësi social, kush tjetër do ta bëjë në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Merita Xhafa** - Punonjësi social në bashkëpunim me mekanizmin e referimit kundër dhunës.

**Ulsi Manja** – Urdhëroni!

**Besa Shahini** – Për ne është e rëndësishme që të vendoset punonjësi social, sepse është personi kyç që koordinon të gjithë punën e grupit teknik, të mekanizmit të referimit. Mund ta bëjmë në bashkëpunim me mekanizëm, por punonjësi social, patjetër duhet të jetë koordinatori vendor, që të mos vendoset një tjetër.

**Vasilika Hysi** – Pra, “Punonjësi social, pranë njësisë në bashkëpunim me anëtarin e mekanizmit, përgatit raportin për të gjithë punonjësit”.

**Ulsi Manja** – Jam dakord me këtë sugjerim.

Kush është dakord me nenin 8, me sugjerimin e bërë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9.

**Vasilika Hysi** – Neni 9 ka shumë ndryshime, sepse është nen që prek disa paragrafë. Neni 9 i projektligjit ndryshon nenin 10. Për këtë nen kanë shprehur mendime dhe sugjerime: Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Ne kemi bërë riformulim të germave “k” dhe “j”. Njëkohësisht, në bashkëpunim me ekspertët e ministrive, bazuar në sugjerimin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, përmbajtjen e pikës m/1, m/2 dhe m/3 e kemi bashkuar te m/1, dhe m/2 dhe m/3 hiqet.

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me nenin 9, me riformulimet e bëra nga relatorja?

Ministria e Drejtësisë?

**Adrian Shega** – Dakord.

**Merita Xhafa** – Dakord.

**Besa Shahini** – Dakord.

**Ulsi Manja** - Kush është dakord me nenin 9, me sugjerimin e bërë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Kalojmë te neni 10, që ndryshon nenin 13.

**Vasilika Hysi** - Neni 10 synon të shtojë një nen të ri pas neni 13, që është neni 13/1, ky nen është zemra e ligjit. Për herë të parë ky nen parashikon urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme. Pra, sot ne kemi urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje dhe urdhër mbrojtje që të dy këta urdhra jepen nga gjykata. Ky urdhër paraprak i mbrojtjes garanton, atë që unë e thash në fillim dhe që e konfirmoi zëvendësministrja e Punëve të Brendshme, që për 48 orë ne viktimat i kemi jashtë mbrojtjes dhe në pjesën më të madhe në atë periudhë ndodh gjithçka.

Ka pasur një debat të madh, dhe unë do të sugjeroja që ta diskutonim, zoti kryetar, dhe në qoftë se nuk do të arrinim në një kompromis se cili do të ishte varianti më i mirë, varianti që propozon Komisioni për Punët dhe Çështjet Sociale, që e ka sjellë dhe qeveria, apo varianti që ka sjellë Ministria e Brendshme? Ministria e Brendshme thotë që të mos jetë urdhër paraprak për mbrojtjen, por të jetë masa paraprake e mbrojtjes së menjëhershme. Ndërkohë, pyetja që ne shtruum për përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme është: këto masa kush do t'i japë? Do t'i japë punonjësi i policisë. Si do t'i japë masat? Nëpërmjet një urdhri. Atëherë çfarë është? Është një urdhër, urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes. Diskutimi që kemi bërë me ekspertët, hartues të ligjit, me pedagogët e Shkollës së Magjistraturës, edhe me profesoreshë Aurela Anastasi, për të parë kushtetutshmërinë, është se ky urdhër është shumë i domosdoshëm, është në kuadër të masave administrative, është kushtetues dhe shumë shpejt do të kalojë në gjykatë për t'u vlerësuar.

Kolegia Bushka, unë do të prezantoj edhe kontributin e koleges Bushka, që është njohëse shumë e mirë e kësaj çështje, mendon se tri urdhra mbrojtje janë shumë: “urdhri paraprak i mbrojtjes së menjëhershme”, “urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes” dhe “urdhri i mbrojtjes”. Jemi rikthyer për ta ditur edhe për transparencë dhe për rekorde, mendojmë se edhe ky urdhër, që merr punonjësi i policisë, do të shkojë në gjykatë.

**Ulsi Manja** – Pse tri urdhra?

**Vasilika Hysi** - Sepse periudha prej 48 orësh, derisa mblidhet gjykata..

**Ulsi Manja** – Kjo është e zgjidhur, nuk e di pse keni bërë kaq shumë diskutim për këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Deri në marrjen e urdhrin nga gjykata, sepse gjykata ka afate të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, niveli i vendimmarrjes administrative brenda strukturës policore është i përcaktuar. Viktima që në momentin që i drejtohet Policisë së Shtetit duhet të vihet në mbrojtje. Kush e merr urdhrin, kush do ta firmos urdhrin? Ka nivel hierarkik vendimmarrja. Punonjësi i

policisë nuk mund të jetë subjekti që mund të firmosë urdhrin paraprak të mbrojtjes, është drejtori i policisë, është shefi i komisarariatit, është shefi i rendit, pra ka hierarki në Policinë e Shtetit. Absolutisht, ne do të biem dakord në parim, që viktimës menjëherë t'i jepet mbrojtje, që në momentin e parë, deri në marrjen e vendimit nga gjykata. Por se kush do ta marrë vendimin për vendosjen në mbrojtje, të subjektit, hierarkia policore e ka përcaktuar nivelin e autoritetit policor. Këtu mund të gjejmë një dakordësi. Nëse ka lidhje me përkufizimin në nenin 2, siç propozoi kolegu Hyseni, ne mund ta lëmë të hapur edhe nenin 10 dhe t'i shikojmë në unitet edhe me nenin 2, të përkufizimet. Urdhëroni!

**Etleva Sheshi** – Ne e diskutuam pak më parë me kolegun Hyseni, dhe tha e lëmë të hapur, kjo ka lidhje edhe me këtë që po diskutojmë. Unë them ta lëmë të hapur.

**Ulsi Manja** – Në rregull, sepse edhe unë këtë propozoj, ta lëmë të hapur. Ky nen, meqenëse lidhet me nenin 2 të përkufizimeve, atëherë ne ta lëmë të hapur nenin 10 dhe para miratimit në tërësi, ta kemi dakordësuar edhe nenin 2, edhe nenin 10, sepse është mundësia për të gjetur formulimet e duhura që të jenë të zbatueshme në praktikë.

E shtyjmë votimin për nenin 10, kalojmë te neni 11, që ndryshon pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 14.

**Vasilika Hysi** – Neni 11 që ndryshon pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 14 i janë nënshtruar diskutimit edhe në Komisionin e Sigurisë Kombëtare dhe në Komisionin e Punës dhe Çështjeve Sociale. Njëkohësisht, ne kemi bërë riformulimin e këtij duke pasur parasysh se Kuvendi, pak kohë më parë, ka miratuar edhe ligjin “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, por njëkohësisht keni kaluar edhe ligjin që lidhet me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile. Është një nen shumë i rëndësishëm, i cili ka të bëjë me kërkesëpadinë, pra rregullon aspekte procedurale lidhur me shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Ky nen është riformuluar sipas tabelës që keni përpara.

Zoti kryetar, këtu dua edhe vëmendjen e kolegëve, sepse ka një risi për njoftimin: “Moskonfirmimi i njoftimit prej palëve nuk e pengon gjykatën të vazhdojë gjykimin dhe të vendosë për një nga urdhrat e mbrojtjes”. Këtu dua mendimin tuaj.

**Ulsi Manja** – Është shumë i saktë, sepse, nëse ne po themi se kërkojmë të lëshojmë një urdhrë urgjent mbrojtjeje, që në momentin kur viktimë kërkon ndihmë në autoritetin policor, nuk ka se si të pengojmë vazhdimin e gjyimit kur kjo çështje shkon në gjykatë për shkak të mosnjoftimit të palëve. Nuk do të kishte logjikë nëse nuk do ta shtonit këtë.



**Vasilika Hysi** – Riformulimi i pikave 3, 4 dhe 5 është bërë dhe ne do të donim konfirmimin nga Ministria e Drejtësisë, sepse ka të bëjë me procedurë civile.

**Ulsi Manja** – Ministria e Drejtësisë.

**Ardian Shega** – Në nenin 14 rregullohet vetëm pjesa e kërkesëpadisë për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes. Pra, nuk parashikohet urdhri paraprak i menjëhershëm, që, sipas variantit të propozuar, do të lëshohet nga policia. Në këto kushte i gjithë shqetësimi është në momentin që nuk kemi njoftim të palëve, mund të ndodhë që të jemi në kundërshtim me standardet e vendosura në Kodin e Procedurës Civile në lidhje me njoftimin e palëve për proces të rregullt ligjor.

**Ulsi Manja** – Ministria e Drejtësisë kërkon që kjo të shikohet në uniformë edhe me Kodin e Procedurës Civile. Gjithsesi, ne mund ta lëmë të hapur nenin 11, por, ju lutem, gjeni formulimin e duhur për të ndihmuar viktimat për një arsye shumë të thjeshtë, në vlerësimin tim mjafton që në gjykatë të paraqitet personi apo viktima që ka kërkuar mbrojtjen. Kjo duhet të shikohet në kuptimin zgjeruar edhe të interpretimit të Kodit të Procedurës Civile, sepse mund të shkojë viktima dhe nuk vjen pala kundërshtare. Çfarë do të bëhet? Pastaj duhet të zgjasim afatin e urdhrit të menjëhershëm policor deri në dhënien e vendimit nga gjykata. Pra, ose duhet të zgjasim afatin, të shprehemi tek urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes që e merr autoriteti policor dhe të themi: “Urdhri pushon së vepruari në momentin që del vendimi i gjykatës”. Kështu mund të zgjidhet, dhe i gjejmë të dyja palët, por në asnjë minutë viktima, nga momenti që kërkon mbrojtje, nuk duhet të lihet pa mbrojtjen e nevojshme nga shteti. Pra, që të jemi shumë të qartë në këtë pikë. Është një ligj që mjafton të bëjmë ligjin e duhur, edhe pse do të na marr kohë, ne nuk e kemi me ngut. Kemi dy seanca përpara për ta votuar, është seanca e datës 19 dhe e datës 23 korrik, dhe kjo është në seancën e fundit. Kemi kohën e duhur në dispozicion për të bërë një ligj ashtu siç duhet. Kështu që deri të hënën duhet t’i keni sjellë të gjitha sugjerimet përkatëse për nenet që lamë të hapura. Merita keni ndonjë gjë për të shtuar?

**Merita Xhafa** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, mund të shprehemi në përgjigje të propozimit të përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë, në referencë të Kodit të Procedurës Civile, sepse, realisht, këtu nuk ka ndonjë gjë që ta komplikojë situatën apo zbatimin e këtij neni. Për më tepër përkufizimin për urdhrin e menjëhershëm paraprak të mbrojtjes ne e lamë te neni 2, kështu që është i lidhur. Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Dakord, e lëmë edhe nenin 11 të hapur, që ta dakordësojmë si dy nenet e tjera. Kalojmë te neni 12.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Neni 12 sjell një ndryshim në nenin 15 të ligjit bazë. Ka një koment nga Komisioni i Sigurisë. Pra, ideja është që moslëshimi i dokumenteve që kërkon viktima të dënohen administrativisht me gjobë. Ne kemi bërë një riformulim, sepse gjoba nuk është zgjidhja e mirë, personi edhe mund të hiqet nga puna, mund të ketë edhe masa të tjera disiplinore. Kemi bërë riformulimin: “Për moslëshimin e dokumentacionit të përcaktuar në këtë paragraf, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personit përgjegjës bazuar në dispozitat e legjislationit të posaçëm”. Në qoftë se personi është shërbim civil ka gjobë, ulje page, pra i ka shumë më të rënda se sa 100 mijë lekëshin. Unë nuk mund të pajtohem, dhe bashkë me kolegët thamë që të dënohet me 100 mijë letë të vjetër dhe ndërkohë të vazhdojë të jetë në punë një njeri që shkel në mënyrë sistematike të drejtat e viktimës.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, ma sqaroni edhe një herë si e keni bërë këtë nen.

**Vasilika Hysi** – Neni 15 i ligjit bën fjalë për provat në procesin gjyqësor, ku thuhet se provat që duhet të paraqiten në gjykatë, mund të jenë: dëshmi, raporti i policisë, raporti mjekësor, dokumente që lëshojnë zyrat e shërbimeve sociale. Në rast se viktima bën një kërkesë të qartë komisarariatit, organeve qendrës shëndetësore për të marrë një provë shkresore, zoti kryetar, ato janë të detyruara t’ia japin. Nëse ato nuk e japin kopjen e certifikatës dhe të kërkesës, që të thotë se unë kam bërë një ankim në polici.

**Ulsi Manja** – Më duket shumë e lehtë, kjo përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore për një autoritet shtetëror, që i kërkohet një dokument për t’u paraqitur në gjyq, për të marrë një masë ndaj viktimave të dhunës në familje.

**Vasilika Hysi** – Në qoftë se është veprë penale, kemi veprën penale dhe Kodin Penal të përdorimit...

**Ulsi Manja** - Edhe ndëshkimi administrativ nuk duhet të jetë për fillimin e një ecurie disiplinore, duhet të jetë më i ashpër.

**Vasilika Hysi** – Si mendoni? Ta riformulojmë edhe këtë?! Ne e kemi forcuar.

**Ulsi Manja** - Një njeriu që është në zyrë shteti i kërkohet lëshimi i një dokumenti për në gjykatë për të marrë një masë mbrojtjeje, ndaj një subjekti të dhunës në familje, dhe ne mjaftohemi me faktin, kur nuk përbën veprë penale gjithmonë, themi 10 mijë lekë gjobë e ka varianti.

“Moslëshimi i dokumentacionit të përcaktuar në këtë paragraf përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personit përgjegjës, bazuar në dispozitat e legjislacionit në përkatës”. Kjo më duket e lehtë. Ky njeri nuk duhet ta marrë më rrogën e shtetit, jo më të jetë në punë, që të mos kujtohem më vonë, kur të vijmë te masa ekstreme e vrasjes, për shkak të dhunës në familje, të fillojmë dhe kërkojmë ne se kush ishte punonjësi që nuk e lëshoi dokumentin, pse u vonua dhe ku u vonua? Jo, ky njeri nuk e meriton më të paguhet me taksat tona. Gjithsesi, duhet të shikohet e harmonizuar me të gjithë kuadrin ligjor përkatës, por unë mendoj se masat administrative të jenë ekstreme.

**Vasilika Hysi** – Unë jam shumë dakord me ju. Madje ne e kemi forcuar, sepse në nenin 15, paragrafi 2, të ligjit që është në fuqi, thuhet: “Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisaritet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar”, por shumë herë ndodh që komisaritet e policisë nuk e lëshojnë kopjen e dokumentit, aktin mjekoligjorë e të tjerë. Po në këtë nen thuhet: “Në rast të moslëshimit të dokumentit të mësipërm personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative”. Këtu është shtuar edhe gjoba.

Ne kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet se në këtë ligj nuk mund ta vendosim si vepër penale. Unë jam shumë dakord me ju që kjo është një vepër e rëndë dhe asnjë funksionar i shtetit, që nuk i jep viktimës një dokument që i duhet për në gjykatë, nuk mund të qëndrojë më në punë. Madje ai duhet ta çojë vetë në gjykatë, pa e detyruar viktimën të kërkojë dokumente. Pra, duhet t’i shërbejë viktimës dhe gjithë procesit.

Megjithatë, ...

**Ulsi Manja** – Që të jemi korrektë dhe në harmoni me të gjithë kuadrin ligjor që kemi në fuqi, propozimi im ishte konkret. Ne jemi dakord që nuk mund të japim disa masa ndaj një subjekti, sepse çështja apo kufiri i masës administrative me masat e tjera është i ndarë, por nëse do të qëndrojmë në suazën e masave administrative, ky person duhet të marrë masën ekstreme. Kjo është e thjeshtë. Një nëpunës shteti që nuk del nga lokali, pasi është duke pirë raki, për t’i dhënë një dokument një subjekti të dhunës në familje, sepse e detyron ligji, nuk e meriton që të marrë rrogën me taksat tona. Në këtë komision jemi shumë kolegë juristë, ndaj hajdeni të gjejmë një zgjidhje se si t’i harmonizojmë këto masa.

**Isida Koka** – Masa më ekstreme do të ishte shkarkimi nga puna, por këtë masë e kemi të pamundur ta parashikojmë këtu, sepse kemi disa raste kur marrëdhëniet e punës rregullohen me ligj specifik. Për shembull, ligji "Për shërbimit civil" është një ligj me 3/5-at, ndaj nëse masën "shkarkim nga puna" do ta parashikojmë në një ligj të thjeshtë mund të kemi përplasje ndërmjet dy ligjeve. Kështu, mendoj që si fillim ta lemë si ecuri disiplinore dhe më pas do të jetë komisioni i disiplinës që, sipas legjislacionit të posaçëm, do të vlerësojë rast pas rasti dhe do të vendosë masën.

**Vasilika Hysi** - Po, edhe masën e shkarkimit.

**Ulsi Manja** – Komisioni i disiplinës rast pas rasti kur të ndodhin ngjarjet, do të mjaftohet me një vërejtje dhe ai punonjës përsëri do të fillojë punë në zyrat e shtetit, kurse ju do të prisni viktimën e radhës për ta përsëritur gjënë.

Zoti Hyseni, a keni ndonjë mendim për këtë?

**Alket Hyseni** - Së pari, duhet të kemi parasysh se ne po shkojmë drejt një sistemi ku një sërë dokumentacionesh po bëhen online. Ndërkohë që ne po bëjmë shumë sakrifica në aspekte të tjerë unë mendoj se edhe këtu mund të bënim një sakrificë dhe t'ua lëmë në kompetencë organeve të posaçme marrjen e dokumenteve, duke lehtësuar kështu viktimën. Tashmë një viktimë e dhunës në familje ka një stres të akumuluar nga ndjesia që është pa mbrojtje dhe e ka shumë të vështirë të grumbullojë edhe dokumentacionin sado të thjeshta që janë në këto raste. Kështu që mendoj se për një ligj të tillë ne duhet të marrim kohën e nevojshme dhe të mos kalojmë sot, por propozoj që ta diskutojmë më mirë.

**Ulsi Manja** – Për dokumentet e keni fjalën?

**Alket Hyseni** - Pra t'ia ngarkojmë njërës prej zyrave, ndoshta komisariateve. I gjithë fokusi është drejtuar pikërisht te shteti dhe ky mekanizëm i madh mund të eliminojë dhunën në familje. Nëse nuk e bëjmë këtë, atëherë çfarë mund të bëjmë tjetër? Këtë gjë mund ta bëjë komisariati i policisë, mund ta bëjë Zyra për Dhënien e Ndihmës Juridike Falas, si linjë dytësore në këtë rast, që është parashikuar, por mund ta bëjnë edhe organet e pushtetit lokal. Unë gjithnjë kam dëshirën që t'ia heqim viktimës barrën e grumbullimit të dokumentacionit.

**Ulsi Manja** – Pra, ju sugjeroni që t'ia heqim barrën viktimës dhe t'ia kalojmë barrën e dorëzimit të dokumentacionit në gjykatë ndonjë institucioni?

**Alket Hyseni** – Po, ose mund ta bëjmë me kërkesë të gjykatës. A mund ta bëjmë për një ligj procedural gjyqësor? A mund ta detyrojmë gjykatën me këtë ligj? Prandaj unë nuk u shpreha

për gjykatën, duke gjykuar se mund t'ia lemë ndonjë institucioni tjetër, si, për shembull, policisë apo administratës.

**Ulsi Manja** – Pra, ju mendoni që t'ia kalojmë barrën e dorëzimit të dokumentacionit ndonjë institucioni.

**Alket Hyseni** – Varet edhe se çfarë mendimi ka ministria, nëse do ta përballojë dot këtë gjë. Prandaj, unë mendoj që relatorja, së bashku me ekspertët dhe me ministrinë përkatëse, ta diskutojnë edhe një herë dhe më pas të vazhdojmë.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Unë jam shumë dakord, sepse nëse do t'i referohemi nenit 15, paragrafi 2, të ligjit në fuqi, kërkesën mund ta bëjë ose viktimja, ose gjykata. Pra, për të dyja rastet edhe kur kërkesën e bën viktimja, por edhe kur e bën gjykata, nëse autoriteti nuk përgjigjet, personat përgjegjës duhet të mbajnë përgjegjësi disiplinore plus duhet të marrin edhe gjobë.

Nëse do të vini re ne kemi parashikuar dy masa administrative: përgjegjësi disiplinore në varësi të ligjit të posaçëm, që rregullon marrëdhëniet për policinë, gjendjen civile, spitalet, nëpunësit civilë, por edhe gjobën. Nga ana tjetër, shqetësimi që ka zonja Elena unë mendoj se është parashikuar që mund ta kërkojë gjykata, por sugjeroj (më vjen mirë që të gjithë kolegët kanë ndjeshmëri), që ta lemë të hapur për t'ia lehtësuar barrën viktimës për marrjen e dokumenteve. Pra, të mos e detyrojmë viktimën që të shkojë të mbledhë dokumentet dhe të bëjë kërkesën.

Megjithatë, zoti Hyseni, në qoftë se viktimja kërkon një kopje të denoncimit, një kopje të raportit ligjor, sot që ne flasim institucionet nuk i japin. Pra, viktimja kërkon të ketë një kopje të kërkesës që ka bërë në polici, prandaj unë mendoj që ta lemë të hapur këtë nen dhe ta diskutojmë.

**Ulsi Manja** – Jam dakord me sugjerimin që ta lemë të hapur këtë nen, gjithmonë në sensin e mbrojtjes së viktimës, sepse mjafton vetëm fakti që viktimja e dhunës në familje është një njëri i traumatizuar dhe nuk është në gjendje të mbledhë dokumentet në çdo institucion për t'ia paraqitur në gjykatë. Prandaj, e lemë të hapur këtë nen, në mënyrë që ta shikojmë më mirë.

Po, zonja Xhafa.

**Merita Xhafa** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do t'ju lutesha që ta rishikoni edhe një herë, pasi marrëdhëniet e punës për secilin kanë disa akte ligjore mbi bazën e të cilave rregullohen. Pra, nga pikëpamja e teknikës legjislativë nuk bën sens që ta lemë të hapur një nen, i cili është i rregulluar me disa akte ligjore, qoftë nga Kodi i Punës, qoftë edhe nga ligji "Për shërbimin e nëpunësit civil". Unë jam shumë dakord me

propozimin tuaj, që të merret një masë ekstreme dhe kjo masë mund t'u referohet të dyja këtyre ligjeve ose mund të kalojmë në aktin tjetër, që të bëhet një procedim në gjykatë për personin, i cili nuk e ka mbështetur me dokumente respektive viktimën ose gjykatën. Unë personalisht do të kërkoja konsensusin tuaj, që të mos e lemë të hapur këtë nen, sepse ka një sërë aktesh ligjore, të cilat e rregullojnë këtë gjë.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, a mund ta marr fjalën?

**Ulsi Manja** – Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Kërkesa e kryetarit të komisionit, por edhe kolegut Hyseni, është që ne të ulemi së bashku për ta forcuar këtë nen. Pa dyshim duke parë ligjin “Për Policinë e Shtetit”, ligjin “Për gjendjen civile”, ligjin "Për shërbimin e nëpunësit civil" dhe çdo ligj tjetër, gjykata mund t'i vendosë një punonjësi dhënien e një gjobe 10 mijë lekë, por duhet të shikojë edhe Kodin e Procedurës Administrative.

**Ulsi Manja** – Ideja është që nga raporti, që është sot institucion-viktimë –gjykatë, ne të heqim viktimën dhe të lemë drejtpërsëdrejti vetëm raportin institucion-gjykatë. Patjetër që kur viktima do të kërkojë kopje të ekstrakteve, nuk diskutohet që do t'i jepet, por nëse sot, në variantin e propozuar, kemi një marrëdhënie të tillë institucion- viktimë –gjykatë, unë mendoj që ta heqim viktimën nga kjo marrëdhënie dhe dokumentacioni që kërkohet nga gjykata të jetë detyrim i institucionit dhe jo i viktimës. Pra, viktimës t'i vihet në dispozicion kur e kërkon i gjithë dokumentacioni, prandaj duhet ta lemë të hapur këtë nen.

Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne po flasim për momentet e para të dhunës kundrejt viktimës. Prandaj, siç e tha edhe kolegu Hyseni, në momentet e tronditjes së madhe psikologjike viktima nuk është e aftë që të mbledhë dokumentacionin për ta paraqitur në gjykatë. Pasi kalojnë këto momente dhe pasi merret edhe masa paraprake nga gjykata, atëherë viktima do të jetë në kushte më të mira për të mbledhur dokumentacionin dhe për të pajisur me kopjet e saj, duke i dhënë kështu edhe një drejtim mënyrës se si do të mbrohet apo procedurat e tjera që do të ndiqen, për shembull, nëpërmjet një avokati personal apo një avokati të nivelit të dytë, që mund të jetë falas nga shteti e të tjerë. Pra, në momentet e para që viktima ka nevojë për mbrojtje të menjëhershme sugjerojmë që dokumentacioni, që mund të jetë një certifikatë ose një akt ekspertimi, të mblidhet nga policia, në

mënyrë që të marren masat paraprake. Më pas detyrimisht viktimat do të vazhdojnë t'i ndjekë personalisht të gjitha procedurat.

**Ulsi Manja** – Dakord me sugjerimin.

Kalojmë te neni 13, që ndryshon pikën 1 të nenit 16.

**Vasilika Hysi** – Jemi dakord me variantin e propozuar nga qeveria.

**Ulsi Manja** – E hedhim në votim nenin 13

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14, që ndryshon nenin 19.

**Vasilika Hysi** – Te neni 14 kemi hequr shprehjen "zgjidhet me alternativat e pajtimit apo të ndërmjetësimit", sepse standardet europiane nuk e lejojnë përdorimin e alternativës. Pra, shprehja "zgjidhet me alternativat e pajtimit apo të ndërmjetësimit" zëvendësohet me shprehjen "zgjidhet me pajtim ose me ndërmjetësim".

**Ulsi Manja** – Nga ministria kush ka ndonjë gjë?

**Adrian Shega** - Kam vetëm një sugjerim: në pikën 6 të projektligjit thuhet: "Vendimi përfundimtar i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet." Ndërkohë që në pika 3/ç të po këtij neni "Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes", thuhet: "Njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditëve nga shpallja apo marrja dijani e tij". Nëse do të miratohet drafti sipas projektligjit, i bie që germa "ç" e pikës 3 të shfuqizohet, sepse nuk ka më ankime për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

**Ulsi Manja** – Po, relatorja.

**Vasilika Hysi** – Ne jemi dakord me paragrafin e parë, ku thuhet: "Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me alternativat e pajtimit a të ndërmjetësimit". Unë nuk e kuptova lidhur me pikën e dytë.

**Adrian Shega** – Edhe me pikën e dytë ne jemi dakord, por thjesht germa "ç" e pikës 3 të shfuqizohet, sepse thuhet: "Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban: ç) "njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditëve nga shpallja apo marrja dijani e tij".

**Vasilika Hysi** – Jam dakord.

**Ulsi Manja** – Pra, jeni të gjithë dakord me sugjerimin e bërë nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë për nenin 14? Dakord!

Atëherë, e hedhim në votim nenin 14

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 15, që ndryshon nenin 20.

**Vasilika Hysi** – Jemi dakord me variantin e propozuar nga qeveria.

**Ulsi Manja** – E hedhim në votim nenin 15.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16.

**Vasilika Hysi** – Te neni 16 kemi bërë një ndryshim të pikës 2, që reflekton edhe rolin e ri të Gjykatës së Lartë: “Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë”. Pra, nuk lejohet ankim nga viktima ndaj vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.

**Ulsi Manja** – A janë dakord të gjithë përfaqësuesit e ministrive? Dakord!

E hedhim në votim nenin 16.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17, që ndryshon nenin 23.

**Vasilika Hysi** – Jemi dakord me variantin e propozuar nga qeveria.

**Ulsi Manja** – A janë dakord të gjithë përfaqësuesit e ministrive? Dakord!

E hedhim në votim nenin 17.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18.

**Vasilika Hysi** – Jemi dakord me variantin e propozuar nga qeveria, por propozoj që të shtojmë afatet në bazë të Kushtetutës, sepse jemi të detyruar që të përcaktojmë aktet nënligjore, institucionet përgjegjëse dhe sa kohë duhet.



Kam një pyetje: sa kohë ju duhet për të përgatitur aktet nënligjore respektive, qoftë Ministria e Brendshme, qoftë Ministria e Shëndetësisë, qoftë Ministria e Mbrojtjes Sociale apo Ministria e Drejtësisë.

**Rovena Voda** – Besoj se ne do të jemi gati për 3 deri në 6 muaj.

**Ulsi Manja** – Po flasim për afatet e nxjerrjes së akteve nënligjore.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, ky ligj hyn në fuqi në javën e tretë të gushtit. Në muajt shtator, tetor, nëntor besoj se duhet të punojnë, pasi ne e kemi sjellë këtë ligj për të mbrojtur njerëzit. Kështu, besoj se 3 muaj mjaftojnë, sepse vetëm një rishikim të urdhrave do të bëjnë.

**Adrian Shega** – Na duhen 4 muaj.

**Ulsi Manja** – Ne e llogarisim që të filloni punën që në javën e parë të shtatorit.

Po, zonja Xhafa.

**Merita Xhafa** – Në fakt, përgatitja e këtyre akteve nënligjore, për të qenë realistë nuk mund të bëhet vetëm nga një institucion, sepse natyrisht që do të ketë nevojë për bashkëfirmosje. Pavarësisht se legjislacioni nuk e përmban konsultimin me grupet e interesit, ne jemi të detyruar që t'i konsultojmë me grupet e interesit dhe me pushtetin vendor dhe kjo punë kërkon një kohë të konsiderueshme. Për mua afati 6 muaj do të ishte shumë mirë.

**Vasilika Hysi** – Zonja Xhafa, në rast se ne do t'ju lemë kohë 6 muaj, ky ligj do të bëhet efektiv në janar. Në qoftë se nuk e keni këtë emergjencë, unë jam dakord, por nga të gjitha këto diskutime që ne kemi bërë këto ditë, edhe me grupet e interesit në seancat dëgjimore, ka rezultuar se kjo punë është emergjente.

**Ulsi Manja** – Këshilltarja këtu po më sugjeron se aktet nënligjore bëhen vetëm në nivel ministrish.

**Merita Xhafa** – Po, jam shumë dakord dhe në datën 1 janar ky ligj do të jetë efektiv.

**Ulsi Manja** – Sa kohë i bie deri më 1 janar.

**Vasilika Hysi** – Janë 4 muaj afat.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, e mbyllim nenin 18? Aktet nënligjore do të jenë gati në datën 1 janar, pra brenda 4 muajve nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit.

E hedhim në votim nenin 18.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19, që është hyrja në fuqi e ligjit.

**Vasilika Hysi** – Jemi dakord.

**Ulsi Manja** – E hedhim në votim nenin 19.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Këtu e mbyllim shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar””. U lutem relatorëve, këshilltarëve, përfaqësuesve të 4 ministrive, por edhe kolegëve të mi deputetë, që dhanë mendime dhe sugjerime, që këto nene, të cilat i kemi lënë të hapura, t’i mbyllim deri ditën e hënë. Në mbledhjen e radhës kur ta votojmë projektligjin në tërësi do t’i miratojmë edhe nenet e hapura për t’ia drejtuar më pas seancës plenare në datën 23 korrik.

Sekretaria e Komisionit të Ligjeve, këshilltarja dhe relatorja të marrin masat e nevojshme që ky projektligj të marrë votat e deputetëve në datën 23 korrik, pasi është një projektligj shumë i rëndësishëm.

Ju ftoj që ta diskutoni me të gjithë seriozitetin e duhur! Ftoj edhe mediet që t’i bëjnë pasqyrimin e duhur këtij projektligji shumë të rëndësishëm, i cili merr në mbrojtje viktimat e dhunës në familje, në mënyrë që të mos mjaftohemi vetëm me kronikat që bëjnë mediet kur ndodhin ngjarje të tilla, por që mbrojtja e viktimave të dhunës në familje të jetë reale, jo sepse ne nuk e kemi ligjin, por, nisur nga problematikat që ne kemi, ky projektligj u jep mbrojtjen e duhur viktimave të dhunës në familje. Faleminderit!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.07.2018, ora 10.00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Raporti vjetor i veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Nasip Naço, Edmond Panariti, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

**Mungojnë:** Enkelejd Alibeaj, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Fatmir Mediu, Silva Caka

#### **Të ftuar:**

Shkëlqim Ganaj – Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI

Evgjeni Bashari – Inspektore e Lartë në ILDKPKI

Flori Karaj – Inspektor i Lartë në ILDKPKI

Renata Teta - Specialiste në ILDKPKI

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, me raportin vjetor të veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Adnor Shameti.

Të ftuar në komision janë zoti Shkëlqim Ganaj, inspektor i Përgjithshëm i ILDKPKI-së; zonja Evgjëni Bashari, inspektore e Lartë; zoti Flori Karaj, inspektor i Lartë, dhe zonja Renata Teta, specialiste.

Para se t'i jap fjalën inspektorit të Përgjithshëm, dua të sjell në vëmendje të kolegëve se raporti analitik i ILDKPKI-së për vitin 2017 është paraqitur brenda afatit në Kuvendin e Shqipërisë dhe është bërë publik edhe në internet në faqen zyrtare të Kuvendit. Ndërkohë, u bëj me dije kolegëve deputetë se nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura kemi një raport të detajuar lidhur mbi gjetjet që ka bërë ky institucion.

Gjithsesi për një informacion më të detajuar për kolegët, por edhe për opinionin publik do t'ia kaloj fjalën inspektorit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave zotit Shkëlqim Ganaj.

Zoti Ganaj, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Me raportimin tuaj Komisioni i Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë e mbyll fazën e raportimit të institucioneve të pavarura dhe kushtetuese në këtë komision, si një nga format e kontrollit parlamentar, më pas ky raport dhe rezoluta do t'i përcillet Kuvendit të Shqipërisë për në seancën plenare të radhës. Fjala për ju.

**Shkëlqim Ganaj** – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Për vitin 2017 Inspektorati i Lartë përveç ligjeve bazë të deklarimit e kontrollit të pasurive dhe parandalimit e konfliktit të interesave, ka qenë i detyruar të përballojë një ngarkesë mjaft të madhe për shkak të hyrjes në fuqi në tetor të ligjit “Për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në sektorin publik”, me 165 njësi përgjegjëse, në janar ka hyr në fuqi ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në korrik ligji “Për sinjalizuesit në sektorin privat” me 446 njësi përgjegjëse. Në raport janë detajuar të gjitha të dhënat për të katër ligjet.

Për sa i përket ligjit për kontrollin e deklarimit e pasurive, Inspektorati i Lartë për vitin 2017 ka administruar rreth 7000 deklarata, të cilat u janë nënshtruar kontrollit aritmetik dhe logjik

brenda afatit dhe në mënyrë të plotë. Është përfunduar kontrolli i plotë, sipas planit vjetor, ku 300 zyrtarë janë gjetur në shkelje të ligjit. Janë referuar në organin e prokurorisë dhe strukturave të hetimit tatimor të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave rreth 32 zyrtarë.

Për sa i përket ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, janë vendosur 140 masa administrative.

Viti 2017 në tërësi ka qenë i fokusuar te ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Të gjitha kapacitetet e institucionit janë vendosur për zbatimin e këtij ligji. Në janar pritëm deklaratat e 800 gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në muajt shtator dhe tetor, me konstituimin e organeve për rivlerësimin kalimtar, filluam dorëzimin e dosjeve dhe raporteve përfundimtare. Fillimisht është dorëzuar lista prioritare që përfshin Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese, kandidatët për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme. Të gjitha raportet dhe dosjet përkatëse janë dorëzuar në afat. Në muajin nëntor u dorëzua lista prioritare dhe pastaj kemi vijuar me radhë me gjyqtarët e gjykatave të apelit, me kryetarët e gjykatave të apelit dhe shkallëve të para.

Në vitin 2018 kemi vijuar me dorëzimin e raporteve dhe dosjeve të kontrollit të plotë për pjesën tjetër të mbetur të prokurorëve dhe gjyqtarëve të shkallëve të para.

Ju jeni në dijeni të rezultateve të para të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe të dhënat e para janë shqetësuese. Rezulton që 50% e tyre kanë probleme me fshehje të pasurisë, me deklarime të rreme, si dhe me raste të konfliktit të interesit. Pra, është një numër shqetësues, jashtëzakonisht i lartë, duke pasur parasysh që ne si institucion jemi të kufizuar në mjetet e kërkimit dhe në ligj, pra kur te ne ka arritur shifra 50%, imagjini se sa do të arrijnë shifrat më tej, duke marrë në konsideratë aspektin profesional dhe integritetin e figurës. Pra, vetëm për pjesën e pasurisë, për aq sa ne kemi mundësi të bëjmë, shifra ka arritur në 50,1%.

Sipas strukturave dhe ndarjeve të gjyqtarëve, pjesa e gjyqtarëve të apelit ka përqindjen më të lartë të problematikës. Prandaj, duke parë që Gjykata Kushtetuese është jashtë funksionit dhe Gjykata e Lartë ka mangësi të mëdha, me këtë trend që duket në të dhënat e para, unë mendoj që vitin tjetër ne do të jemi pa gjykatë apeli. Pjesa tjetër e të dhënave është konfidenciale dhe nuk mund të vazhdoj.

**Ulsi Manja** – Aktiviteti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017 ka qenë i fokusuar i tëri në subjektet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve?

**Shkëlqim Ganaj** – Po, zoti kryetar.

**Ulsi Manja** – Po detyra të tjera funksionale bazike gjatë kësaj kohe, a janë ushtruar nga ana e Inspektoratit?

**Shkëlqim Ganaj** – Po, janë ushtruar dhe janë të pasqyruara në raport. Jemi munduar të mos lëmë asnjë aspekt mënjanë duke realizuar të gjitha objektivat si për deklarimin e kontrollit të pasurive, si për ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave” ashtu edhe për ligjin e ri “Për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

E përmenda edhe në fillim që janë 440 zyrtarë të ndëshkuar me masa administrative dhe kallëzime penale, janë ushtruar kontrole të plota sipas planit vjetor dhe është ushtruar kontrolli aritmetik e logjik për 7000 deklaratat e regjistruara për vitin 2017. Pra, me gjithë ngarkesën që kemi pasur, jemi munduar të mos lëmë mënjanë asnjë aspekt të punës tonë. Pastaj, të dhëna më të detajuara i keni të gjitha në raportin që keni marrë. Këto ishin pak a shumë shkurtimisht që të mos humbasë dhe kohën tuaj.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Ganaj!

Fjalën e ka relatori, zoti Shametaj dhe pastaj kolegët me pyetje rreth raportit.

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti kryetar!

Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit Kontrollit të Pasurive, si dhe Konfliktit të Interesit, gjatë vitit 2017 prezantohet pranë Kuvendit të Shqipërisë në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 39 të ligjit nr. 9049 të vitit 2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik, i ndryshuar” si dhe të nenit 103 të Rregullores së Kuvendit.

Inspektorati i Lartë nëpërmjet raportit bën të njohur aktivitetin institucional gjatë vitit 2017, për zbatimin e kuadrit të zgjeruar ligjor të tij, masat konkrete të marra në funksion të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, përmbushjen e kërkesave dhe rekomandimeve ndërkombëtare, rishikimin ligjor, bashkëpunimin ndërinstitucional, transparencën e realizuar me medien, si dhe organizmat dhe asistencat ndërkombëtare.

Shërbimi i monitorimit të Kuvendit ka përmbledhur proceset ligjore dhe veprimet që janë kryer në një vit, pra në vitin 2017 si dhe i paraqet ato të përmbledhura. Në vijim edhe të treguesve

të viteve të mëparshme, nga viti 2015 dhe në vijim, gjatë vitit 2017, Inspektorati i Lartë ka dëshmuar nivelin më të lartë të punës, në krahasim me treguesit krahasimorë të punës të realizuar ndër vite të ILDKPKI-së, duke krijuar një statistikë pozitive 4 vjeçare, si në tabelën që i bashkëngjitet këtij raporti.

Viti 2017, është viti që shënon pikun kulmor të angazhimit institucional të Inspektoratit, për shkak të rolit të institucionit të përcaktuar në Kushtetutën e amenduar, si dhe në ligjin e vetingut nr. 84/2016 “Për kontrollin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve, ndihmësve ligjorë, si dhe kandidatëve që shprehin interes në organet e reja të sistemit të drejtësisë”.

Puna e kryer nga inspektorati, si organ ndihmës për procesin e vetingut, shënon edhe indikatorët e parë të rezultateve të vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i ngritur në funksion të ligjit nr. 84/2016. Ky ligj në kriterin e parë për rivlerësimin e subjektit, vlerëson pasurinë e tij duke u bazuar, ndër të tjera, në raportin e verifikimit të inspektoriatit. Duke vërejtur vendimmarrjet e para të Komisionit të Kualifikimit ndaj subjekteve të rivlerësimit, gjyqtarë dhe prokurorë që për shkak të ligjit janë prej vitesh subjekte të deklarimit të pasurisë në inspektoriat, rezultuan disa raste të mos përmbushjes së kriterit të parë të rivlerësimit, pikërisht atë të mospërputhjes së pasurisë me burime dhe të ardhura të ligjshme të gjyqtarit dhe prokurorit, ku në shumë raste raporti i Inspektoratit për pasurinë e subjektit nuk ka korresponduar me raportin e KPK-së për këtë kriter. Analiza bëhet edhe më e thellë dhe më e kujdesshme, por duhet konstatuar apo testuar performanca e punës institucionale të këtyre organeve të pavarura të parashikuara në Kushtetutë. Gjithsesi, çdo vendimmarrje e KPK-së që nuk përputhet me raportin e Inspektoratit do të shikohet nëse është objekt ankimi në Kolegjin e Apelit apo jo.

Është e rëndësishme të theksojmë se Inspektoratit i është shtuar edhe një funksion tjetër kushtetues dhe ligjor, ai për vlerësimin e pasurisë, që ka qenë i ndryshëm nga puna e deritanishme. Inspektorati me ligjin për vetingun në Policinë e Shtetit, do të angazhohet edhe në drejtim të verifikimit të figurave për këtë subjekt të posaçëm, që i shtohet me ligj të veçantë Inspektoratit dhe kjo e bënë më të rëndësishme dhe komplekse punën e Inspektoratit.

Mendoj se raporti i paraqitur është i plotë dhe i gjithanshëm, prandaj ftoj komisionin për ta kaluar dhe miratuar njëzëri.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shameti!

A ka pyetje nga kolegët deputetë? Fjalaën e ka zoti Naço.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti kryetar!

Raportet e paraqitura nga inspektori dhe nga relatori tregojnë qartë për seriozitetin, integritetin dhe përkushtimin e këtij Inspektorati. Unë kam bashkëpunuar me zotin Ganaj dhe do të kthehem disa vite prapa, kur kam qenë ministër i Drejtësisë. Nga zoti Ganaj janë referuar informacione lidhur me 15 gjyqtarë të shkallës së parë dhe të apelit, ku u bë edhe procedura për shkarkimin e tyre, por nuk gjeti mbështetjen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Pyetja ime për zotin Gana është: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit si ka proceduar me këta 15 gjyqtarë, që Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk më mbështeti as mua si ministër dhe as ju?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit zoti Naço!

Fjalën e ka zoti Ganaj.

**Shkëlqim Ganaj** – Faleminderit, zoti Naço!

Siç e shpjegova edhe më parë, radha është e përcaktuar nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe fillimisht, janë duke u marrë në shqyrtim dosjet e anëtareve të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, kandidatëve për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Rastet për të cilat po flisni janë të një niveli më të ulët, janë gjyqtarë apeli dhe gjyqtarë të shkallëve të para. Por unë besoj se duhet të shikohen më me përparësi për shkak të bërjes publike të problematikës që ata kanë pasur, një pjesë e tyre janë kallëzuar penalisht, prandaj shpresoj që me mbarimin e listës prioritare, këto do të jenë rastet e para që do të merren në shqyrtim nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por gjithsesi ata e përcaktojnë kalendarin dhe renditjen e punëve. Ne i kemi dorëzuar dhe e kemi përmbushur detyrimin tonë dhe nuk ka dosje që nuk është dorëzuar.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Naço.

**Nasip Naço** – Unë besoj se këta duhet të ishin të parët në listë, por radha e vendosur nga Komisioni të Pavarur të Kualifikimit do të bëjë edhe përzgjedhjen e tyre. Në këtë listë që ju keni dorëzuar pranë ministrit të Drejtësisë në atë kohë, a ka gjyqtarë që kanë dhënë dorëheqjen për këtë shkak?

Faleminderit!



**Ulsi Manja** – Po, zoti Ganaj.

**Shkëlqim Ganaj** – Jo, asnjë nuk ka dhënë dorëheqjen.

**Ulsi Manja** – A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Zoti Ganaj kam unë një pyetje që lidhet me aksesin në bazën e të dhënave në regjistrat publikë të shtetit. A keni akses direkt në disa regjistra dhe baza të dhënash, flas gjithmonë duke iu referuar ligjit dhe, nëse jo, si ka ndikuar kjo në kapacitetin e trajtimit të çështjeve nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive?

**Shkëlqim Ganaj** – Kërkimi për kontrollet që kryen Inspektorati i Lartë bëhet me shkresë manualisht dhe nuk kemi akses të drejtpërdrejtë. Pas 3 vjetësh përpjekjesh, në shkurt të vitit 2018 me ndihmën e USAID-it dhe të Bashkimit Europian kemi arritur të nënshkruajmë marrëveshjen për sistemin e publikimit *online* dhe aksesin *online* në të dhënat e regjistrave shtetërorë, kjo do të jetë një ndihmë e madhe. Është prokuruar edhe kompania përkatëse, e cila po e zhvillon dhe në shkurt të vitit 2019 presupozohet të mbarohet. Deri tani mospasja e aksesit krijon vështirësi mjaft të mëdha, sepse imagjinoni, vetëm për ligjin për rivlerësimin kalimtar janë dërguar 1 milion e 200 mijë shkresa dhe janë pritur 1 milion e 200 mijë përgjigje me letra, që janë marrë, janë renditur, janë hedhur dhe pastaj janë përpunuar e të tjera, pra është e paimagjinueshme ngarkesa e vitit të kaluar.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, për përgjigjen!

Në fakt, kjo mungesë aksesi direkt në disa regjistra dhe baza të dhënash, gjithmonë në vlerësimin tuaj, a ka ndikuar në vendimmarrjen e KPK-së, sepse ka pasur disa raste sporadike ku vendimmarrja e KPK-së ka qenë në të kundërtën e asaj që ka vlerësuar Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive, pra kjo mungesë aksesi në regjistra dhe baza të dhënash, a e ka çuar KPK-në në një vendimmarrje tjetër?

**Shkëlqim Ganaj** – Po, patjetër që ka ndikuar. Inspektorati është i kufizuar në punën që bën, ndërsa ata nuk kanë kufizime në punën që bëjnë. Ne nuk kemi akses as në sistemin TIMS, ku ata e kanë. Ne kemi akses në hipoteka, në tatime dhe banka, kurse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit janë të pakufizuar dhe i kanë të gjitha mjetet dhe kohën duhur. Nëse neve na është thënë që këtë punë keni për ta bërë për 6 muaj dhe stop, ata janë të pakufizuar deri në 5 vjet.

E kam dëgjuar disa herë këtë shqetësim, por nuk ka asnjë shqetësim në këtë pjesë, që ne kemi gjykuar kështu dhe ata ndryshe, nuk ka diferenca. Ne kemi bërë pasqyrën e asaj që kemi

gjetur deri në një moment të caktuar, ndërsa ata kanë vazhduar analizën më tej. Unë e thashë që nuk kemi akses as në sistemin TIMS, që është një moment shumë i rëndësishëm për të kuptuar historinë e shpenzimeve, që kur ka hyrë sistemi TIMS, në vitin 2004 e në vitet në vazhdim, për të mos thënë për të dhënat që janë jashtë shtetit, që ne nuk kemi asnjë mundësi për t'i parë, kurse Komisioni i Pavarur i Kualifikimi dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit e kanë këtë akses.

Unë nuk shikoj ndonjë shqetësim edhe për rastet që ju përmendni, duhet të jenë 2 ose 3, ne nuk kemi të plotë as dhe një komponent të pasurisë, por kemi një pjesë të komponentit, ndërsa ata kanë plus edhe pjesën e figurës dhe të aftësisë, pra nuk e diskutoj që do të ketë diferenca.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Ganaj!

Këtu e mbyllim me pyetjet.

A ka diskutime nga kolegët? Nuk ka diskutime.

Faleminderit, zoti Ganaj, për raportimin tuaj përpara Komisionit të Ligjeve, për veprimtarinë e Inspektoratit që ju drejtoni për vitin 2017.

Komisioni i Ligjeve do të ketë edhe një rezolutë për Kuvendin e Shqipërisë për aktivitetin e institucionit që ju drejtoni për vitin 2017, i cili do të diskutohet në mbledhjen e radhës, për t'iu paraqitur Kuvendit në seancën plenare. Relatori së bashku me stafin e komisionit, në mbledhjen e radhës të kenë bërë gati rezolutën për gjetjet e punës së Inspektoratit për vitin 2017 dhe rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë do t'ia adresojë institucionit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit për vitin 2018, ku sigurisht procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, krahas procesit të kontrollit të zyrtarëve të tjerë të lartë publikë, do të ngelet prioritet i punës së këtij institucioni, përfshirë këtu edhe detyrimet që burojnë nga ligji i sinjalizuesve.

Edhe një herë faleminderit, për raportimin!

Me këtë pikë të rendit të ditës ne e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës do t'ju njoftohet nga sekretaria e Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

